

detyrë ta mbante rojën në fshatin e vetë dhe në fshatin fqinj të Turjakës/Turjak. Në datën **7.07.1998**, nga ora 12:00, Tahirin e kanë plagosur rëndë gjatë betejës me forcat serbe në **Turjakë/Turjak**. Bashkëluftëtarët e kanë çuar në spitalin e UÇK-së në Irlznic/Rznić [Deçan/Deçani]. Ka ndërruar jetë ditën tjetër. E kanë varrosur në varrezat e fshatit të Baranit/Baran më 9.07.1998.

Burimet: deklarata X.H.T, FDH-29930; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Selmon (Zhujë) Morina

(10.05.1940, shqiptar nga Loxha/Loda, komuna e Pejës/Peç, tregtar, tetë fëmijë)

Rexhë (Haxhi) Morina

(22.07.1962, shqiptar nga Loxha/Loda, komuna e Pejës/Peç, punëtor, gjashtë fëmijë)

Në fillim të muajit korrik të vitit 1998, banorët e **Loxhës/Loda**, në mesin e të cilëve edhe familjet e Selmonit dhe të Rexhës, e kanë braktisur fshatin. Por, ata që të dy ndenjnë me pjesëtarët e UÇK-së për ta mbrojtur fshatin. Në datën **11.07.1-998**, pjesëtarët e forcave serbe e kanë nisur sulmin kundër forcave të UÇK-së. Selmoni dhe Rexha, së bashku me pesë banorë të fshatit, gjendeshin në istikamin që ishte hapur në afërsi të shtëpisë së Haxhi Salihut. Nga ora 11:00, një predhë ka rënë në istikamin ku gjendeshin ata. Selmoni dhe Rexha u vranë në vend, ndërkaq të tjerë u plagosën. Kur ra terri i natës, bashkëshortja e Selmonit u kthye në fshat dhe, me ndihmën e pjesëtarëve të UÇK-së, i varrosi Selmanin dhe Rexhën në varrezat e fshatit. Në vendin e vrasjes së tyre është ngritur një përmendore.

Burimet: deklarata N.M, FDH-13544; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Istref (Ymer) Krasniqi

(10.09.1933, shqiptar nga Turjaka/Turjak, komuna e Pejës/Peç, bujk, dhjetë fëmijë)

Nurije (Ramiz) Krasniqi

(18.08.1942, shqiptare nga Turjaka/Turjak, komuna e Pejës/Peç, amvise, dhjetë fëmijë)

Istrefi me bashkëshorten Nurien jetonin në shtëpinë familjare në **Turjakë/Turjak**.

Katër pjesëtarë të UÇK-së, të veshur në uniforma, kanë shkua te shtëpia e tyre diku nga mesnata, më **12.07.1998**. I thanë Istrefit se e kishin urdhrin e komandantit të shtabit të UÇK-së [emri i tij është i njohur për FDH] që t'i çonin Istrefin dhe Nurijen në shtab në Glllogjan/Glodane [Deçan/Deçani], dhe se do t'i kthenin pas bisedës informative. I futën në një veturë të ngjyrës së zezë dhe shkuan. Ishte kjo hera e fundit që Istrefi dhe Nuria mbaheshin në mend të shiheshin të gjallë. Djali i tyre Imeri ka shkua një ditë më vonë në shtabin e UÇK-së në Vranoc/Vranovac. Atje i thanë se do të informoheshin për fatin e prindërve të tij dhe se ai duhej të shkonte sërish në shtab, një ditë më vonë. Kur shkoi prapë në shtab ditën e nesërme, Imerit i thanë se prindërit e tij ishin liruar nga shtabi i UÇK-së në Glllogjan/Glodane më 13.07.1998. Nga ajo ditë, atyre u humbet çdo gjurmë. Trupat e tyre të pajetë janë gjetur në kanal in e **Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero** më 12.09.1998. Ekspertiza ka treguar se Nurija dhe Istrefi ishin ekzekutuar me armë zjarri. Pas identifikimit të trupave të tyre me anë të analizës së ADN-së, ato iu dorëzuan familjarëve më 27.10.2006. Mbetjet mortore të Istrefit dhe Nurijes janë varrosur në varrezat e fshatit Turjakë/Turjak më 27.10.2006.

Burimet: deklarata I.K, FDH-33521; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdalReforma&int_cid=1-24&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdalReforma&int_cid=1-24&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-);) OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

Velizar (Stoša) Stošić

(11.02.1935, serb nga Bellopoja/Belo Polje, komuna e Pejës/Peç, pensionist, tre fëmijë)

Në datën **18.07.1998**, nga ora 16:30, Velizari u nis me biçikletë për ta kontrolluar pronën e vetë në afërsi të fshatit Loxhë/Loda. Nuk u kthye atë ditë. Ditën tjetër, familjarët e kanë paraqitur rastin e tij në polici. Një muaj më vonë, policia e ka njoftuar familjen se e kishin gjetur biçikletën e Velizarit në pronën e tij. Në fillim të muajit shtator të vitit 1998, në kanal in e **Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero** u zbulua